



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BULQIZË
KËSHILLI BASHKIAK

Komisioni i Përhershëm i Ekonomisë dhe Kontrollit brendshëm financiar

RAPORT VENDIMMARRJE

Nr. 2 datë 10/04/2025

Nr. ___ Prot

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit nr. Prot 01 datë 21/03/2025, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për “Miratimin e raportit të monitorimit të Bashkisë Bulqize Janar Dhjetor 2024”.

Analiza ligjore: (bazueshmëria ligjore),

Bazuar në ligjin 139/2015 “Për Veteqeverisjen Vendore” neni 34 pika 6 të Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetore në Republikën e Shqipërisë”, neni 65 i ndryshuar dhe Ligjin nr. 68, datë 27.04.2017 “Për financat e veteqeverisjes vendore” neni 48

Situata aktuale e funksionit (përshkrim i situatës së shërbimit / funksionit)

Institucioni I bashkisë bulqizë mund të themi që pati një performancë të mirë edhe në mbledhjen e të ardhurave. Treguesi për këtë është tejkalimi I planit për të ardhurave për vitin 2024. Ky tejkalim I të ardhurave është me 14 %, Të ardhurat vendore për vitin 2024 janë planifikuar 111.663 mijë lekë. Të ardhurat e realizuara për vitin 2024 janë 127,199 mijë lekë. Zërat ndikues në realizim të plotë (tejkalimit) të planit të të ardhurave e zë të ardhura nga tarifa për pyjet dhe kullotat me një realizim prej 127% duke u pasuar me të ardhura nga taksa ndikimit në infrastrukturë nga ndertimet e reja. Taksa mbi token bujqesore mbete një nga taksat që arkëtohet më pak në bashkinë Bulqizë.

Shpenzimet e bashkisë Bulqizë.

Shpenzimet e Bashkisë Bulqizë ndahen sipas natyrës në:

- Shpenzime për funksione të veta.
- Shpenzime për funksione të deleguara

Shpenzimet për funksionet e veta, përfaqësojnë funksionet që kanë përgjegjësi ekskluzive nga vetë njesitë e qeverisjes vendore. Financimi i tyre bëhet nga të ardhurat e vetë njesive të qeverisjes vendore dhe nga transferata e pakushtëzuar e buxhetit të shtetit për pushtetin vendor. Shpenzimet sipas natyres së tyre. Paga dhe sigurimet arrin në vlerën e realizimit 95%. Shpenzimet operative arrin në vlerën e realizuar 62%. Transferata të brendëshme ka pasur një realizim në masën 77%. Investime kanë pasur në realizim në masën 57%.

Drejtoria / Sektori përgjegjës
Sektori i Finances

Monitorimi dhe raportimi : (kush monitoron, raporton dhe sa shpesh)

Prefekti, Keshilli

Impakti social / grupet që preken:

Qytetaret e Bashkise Bulqize

A është objekt i konsultimit publik:

Jo

Komisioni i Përhershëm për “ Ekonomine, dhe kotrollin Financiar”, i mbledhur me datën 10.09/2025, shqyrtoi projekt vendimit nr 1, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për “ miratimin e raportit te monitorimit“ paraqitur nga Kryetari i Bashkisë.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,
Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI

1. T'i propozojë Këshillit Bashkiak: (qarko njerën)
 - a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
 - b) miratimin e projektaktit
 - c) refuzimin e miratimit të projektaktit
 - d) miratimin e projekt-aktit me ndryshimet si vijon:

T'i propozojë Këshillit ndryshimet e projekt vendimit si më poshtë vijon te renditura me pika.

Bashkëlidhur argumentat e vendimmarrjes dhe mendimi i pakicës i paraqitur në
proçesverbalin e mbledhjes së Komisionit

Greta Tanc, Greta Kryetar i Komisionit
(emri, mbiemri, firma)

Arijan Hoxha Sekretar i Komisionit
(emri, mbiemri, firma)

Valbona Yani Anetar i Komisionit
(emri, mbiemri, firma)

_____ Anetar i Komisionit
(emri, mbiemri, firma)

Datë 10/04/2025